



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA MEMALIAJ**  
**KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ**

**VENDIM**

**NR.12, DATË 22.10.2025**

**“PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 27.02.2020 e ndryshuar, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës **22.10.2025**:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë **27.10.2025** ora 10:00.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
**Flamur Mushamati**

Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
**Asqeri Muçoima**

Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
**Petrit Lumani**

Anëtari i Kryesisë së Këshillit  
**Arsola Muzha**

